



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 680/5 prot.

Tiranë, më 13.07.2026

V E N D I M

Nr. 24, datë 13.07.2026

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikave 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankësës nr. 2721 prot., datë 23.10.2025 (vijuar me nr. 2721/3 prot., datë 20.11.2025, nr. 680 prot., datë 04.03.2026 dhe nr. 680/4 prot., datë 25.06.2026), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare” kundër Autoritetit Publik/Agjencia e Zhvillimit të Territorit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me anë të kërkesës nr. 100/25 prot., datë 08.09.2025, depozituar edhe në adresën elektronike marjana.banaj@azht.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1- Kopje të dokumenteve ilustruese për lejet e ndërtimit:

- *Lana Riverside Residences, Vendim KKT, datë 25.04.2023, Vendim Nr. 39;*
- *Bond Tower, Vendim KKT, datë 29.05.2024, Vendim Nr. 13;*
- *Tirana Gate, Vendim KKT, datë 01.08.2023, Vendim Nr. 29;*
- *Tirana East Tower Residence, Vendim KKT, datë 01.08.2023, Vendim Nr. 28;*
- *Multifunctional Tower, Vendim KKT, datë 26.12.2023, Vendim Nr. 21;*
- *ABA Business Center, Vendim KKT, datë 20.06.2018, Vendim Nr. 10;*
- *Filigree Tower, Vendim KKT, datë 14.12.2022, Vendim Nr. 17;*
- *Green Tower, Vendim KKT, datë 25.04.2023, Vendim Nr. 33;*
- *Mixed-use Building, Vendim KKT, datë 26.12.2023, Vendim Nr. 24;*
- *Nomad Building, Vendim KKT, datë 26.12.2023, Vendim Nr. 24;*

Për objektet e mësipërme kërkohet informacion në lidhje me:

- 1- Një kopje të dokumentit të lejes së ndërtimit;*
- 2- Një kopje të kontratës/kontratave noteriale së sipërmarrjes, së lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues (projektues) që ka kryer punimet;*
- 3- Një kopje të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronarëve që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;*
- 4- Një kopje të preventivëve të punimeve (kostot e punimeve);*
- 5- Një kopje të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-së);*
- 6- Një kopje të dokumentit që vërteton pagesën e taksës në infrastrukturë.*

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën e regjistruar me nr. 2721 prot., datë 23.10.2025, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”). Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, nëpërmjet shkresës nr. 2721/1 prot., datë 27.10.2026, drejtuar Autoritetit Publik dhe për dijeni ankuesit, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës nr. 6568/1 prot., datë 14.11.2025, përcjellë edhe nëpërmjet e-mail-it të datës 17.11.2025, i ka kthyer përgjigje Zyrës së Komisionerit dhe ankuesit, duke e informuar se:

*“Në lidhje me lejen për objektin **“Lana Riverside Residence”**, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 25.04.2023, me Vendimin nr. 39 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për objektin “Kompleks Hoteleri, Residencial dhe shërbime “Lana Riverside Residences”, 1, 2, 3, 5, 8, 56 kate mbi tokë dhe 6 kate nëntokë”, me vendndodhje në bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Forever Construction” sh.p.k. Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe është lëshuar Dokumenti i Lejes së Zhvillimit nr. 1776/7 prot., datë 18.12.2023.*

Në lidhje me lejen për objektin “**Bond Tower**”, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 29.05.2024, me Vendimin nr. 13 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për objektin “Godinë multifunkionale, shërbim, hoteleri, banim, 44 dhe 55 kate mbi tokë dhe 5 kate nëntokë, me tarracë të shfrytëzueshme”, me vendndodhje në rrugën “Dritan Hoxha”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues “Nova Construction Group” sh.p.k. Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe është lëshuar Dokumenti i Lejes së Zhvillimit nr. 2301/14 prot., datë 01.10.2024.

Në lidhje me lejen për objektin “**Tirana Gate**”, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 01.08.2023, me Vendimin nr. 29 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për objektin “Kompleks banimi, hotellerie me shërbime 1, 25, 39 dhe 50 kate mbi tokë dhe 3 kate parkim nëntokë” në rrugën “Teodor Keko”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqëritë “Xh & M” sh.p.k., “Alfazed” sh.p.k. dhe “Smart Construction Invest” sh.p.k. Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe është lëshuar Dokumenti i Lejes së Zhvillimit nr. 92/8 prot., datë 26.09.2024.

Në lidhje me lejen për objektin “**Tirana East Tower Residence**”, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 01.08.2023, me Vendimin nr. 28 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për objektin “Tirana East Tower Residence” strukturë shërbimi, banimi dhe hotellerie me 3, 26 dhe 27 kate mbi tokë dhe 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Geo Construcyon” sh.p.k. Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, vendim i cili është i shfuqizuar.

Në lidhje me “**Multifunctional Tower**”, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 26.12.2023, me Vendimin nr. 21 ka miratuar Lejen e Zhvillimit për objektin “Godinë polifunkionale 2-33 kate nëntokë me 4 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Fusha” sh.p.k. Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe është lëshuar Dokumenti i Lejes së Zhvillimit nr. 68/26 prot., datë 04.11.2024.

Në lidhje me lejen për objektin “**ABA Business Center**”, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 20.06.2018, me Vendimin nr. 10 ka vendosur për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin “Objekt banimi dhe shërbime me 21 kate mbi tokë dhe 4 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Dervish Hima”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Gener 2” sh.p.k. Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe është lëshuar Dokumenti i Lejes nr. 689 prot., datë 28.02.2019.

Në lidhje me lejen për objektin **“Filigree Tower”**, Këshilli Kombëtar i Territorit, në mbledhjen e datës 14.12.2022, me Vendimin nr. 17 ka miratuar Lejen e Ndërtimit për objektin **“Filigree Tower - strukturë banimi, shërbimi dhe funksione të përziera, me 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë”**, me subjekt zhvillues shoqërinë **“Kuteli” sh.p.k.** Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe Dokumenti i Lejes së Ndërtimit nr. 249/1 prot., datë 30.01.2025.

Në lidhje me lejen për objektin **“Green Tower”**, Këshilli Kombëtar i Territorit, me Vendimin nr. 43, datë 28.12.2020, ka miratuar Lejen e Ndërtimit për objektin **“Godinë polifunkionale “Green Tower”, me vendndodhje në bulevardin “Gjergj Fishta”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Titan Kostruksion” sh.p.k.** Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, si dhe Dokumenti i Lejes së Ndërtimit nr. 334/25 prot., datë 20.08.2024.

Në lidhje me lejen për objektin **“Mixed-Used Building”**, Këshilli Kombëtar i Territorit, me Vendimin nr. 24, datë 26.12.2023, ka miratuar Lejen e Zhvillimit për objektin **“Objekt shërbimi dhe banimi 5-20 kate mbi tokë, me 5 kate nëntokë”**, me vendndodhje në rrugën **“Liman Kaba”, Bashkia Tiranë**, me subjekt zhvillues shoqërinë **“TDT & PARTNERS” sh.p.k.** Në lidhje me vendimmarrjen e mësipërme është sigluar Vendimi shoqëruar me Hartën e Planvendosjes së Strukturave, si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë.

Në vijim, sqarojmë se, referuar nenit 3 **“E drejta e informimit”**, pika 4, të ligjit nr. 119/2014 **“Për të drejtën e informimit”** (ligj të cilit ju i referoheni edhe në shkresën tuaj): **“Informacioni publik, që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjekteve, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”**, si dhe nenit 17 **“Kufizime”**, pika 1, shkronja **“c”**, të cituar më lart, e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit, siç janë preventivat që ju kërkon, Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk mund t’ju vërë në dispozicion të personave të tretë, mbështetur edhe në nenin 8 **“Veprat”**, pika 1, shkronjat **“e”** dhe **“g”** të ligjit nr. 35/2016 **“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”**, veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore; g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi. Gjithashtu, në vijim të përgjigjes së shkresës suaj, ju bëjmë me dije se referuar ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 **“Për mbrojtjen e të dhënave personale”**, i ndryshuar, dokumentacioni që ju kërkon, duke përmendur dokumentacionin e pronësisë, si dhe kontratat e sipërmarrjes, nuk mund t’ju vendoset në dispozicion nga ana jonë, pasi përmbajnë të dhënat personale...”.

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me anë të e-mail-it të datës 20.11.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 2721/3 prot., datë 20.11.2025, ka vijuar ankimin e tij.

Zyra e Komisionerit, nëpërmjet shkresës nr. 2721/4 prot., datë 10.12.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime mbi vijimin e ankimit nga ana e ankuesit.

Nëpërmjet e-mail-it të datës 03.03.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 680 prot., datë 04.03.2026, ankuesi ka vijuar ankimin e tij, duke parashtruar se: *“...Në mungesë të një përgjigjeje nga autoriteti publik, pavarësisht vijimit të ankimit me e-mail-in e datës 20.11.2025 dhe kohës së mjaftueshme të autoritetit (mbi 4 muaj nga dërgimi i kërkesës) për të vënë në dispozicion të informacioneve të kërkuara, ende nuk kemi një përgjigje. Sa më sipër, duke konsideruar edhe kohën e mjaftueshme të marrë nga autoriteti publik, kërkojmë vijimin e ankesës dhe vënien në dispozicion të informacionit sipas objektit të kërkesës...”*.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI-së, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar edhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 680/3 prot., datë 24.04.2026, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi, qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga znj. Brunilda Qershori, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, znj. Alisa Basha, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve dhe znj. Artemis Peposhi kërkuan kohë për të rivlerësuar qëndrimin e Autoritetit Publik.

Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar pranë Zyrës së Komisionerit, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it të datës 07.05.2026, ka njoftuar ankuesin, duke vënë në dijeni edhe Zyrën e Komisionerit se i është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 3071/1 prot., datë 05.05.2026, në lidhje me kërkesën nr. 100/25 prot., datë 08.09.2025.

Ankuesi, nëpërmjet e-mail-it të datës 25.06.2026, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 680/4 prot., datë 25.06.2026, ka vijuar ankimin, duke sqaruar se: *“...nëpërmjet kërkesës nr. 100/25 prot., datë 08.09.2025, dërguar Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, qendra “Res Publica” ka kërkuar të informohet dhe të vihet në dispozicion: Kopje të dokumenteve ilustruese për lejet e ndërtimit... me shkresën nr. 3071 prot., datë 05.05.2026, na është vënë në dispozicion dokumentacioni nga ana e Autoritetit Publik. Pas verifikimit të informacionit është konstatuar se mungon informacioni për të gjitha lejet e ndërtimit; Një kopje të kontratës/kontratave noteriale së sipërmarrjes, të lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues (projektues) që ka kryer punimet; Një kopje të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronarëve që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; Një kopje të dokumentit që vërteton pagesën e Taksës në Infrastrukturë... Krahas dokumenteve të mësipërme, për objektet “Lana Riverside Residences”, “Bond Tower” dhe “Tirana Gate” mungojnë preventivi i punimeve dhe raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis...”*.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI-së.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI-së parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia e Zhvillimit të Territorit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI-së, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike*”.

Konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtuar se *“...referuar nenit 3 “E drejta e informimit”, pika 4, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar... “Informacioni publik, që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjekteve, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”, si dhe nenit 17 “Kufizime”, pika 1, shkronja “c”, të cituar më lart, e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit, siç janë preventivat që ju kërkon, Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk mund t’ju vërë në dispozicion të personave të tretë, mbështetur edhe në nenin 8 “Veprat”, pika 1, shkronjat “e” dhe “g” të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore; g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi... referuar ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dokumentacioni që ju kërkon, duke përmendur dokumentacionin e pronësisë, si dhe kontratat e sipërmarrjes, nuk mund t’ju vendoset në dispozicion nga ana jonë, pasi përmbajnë të dhënat personale...”, lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI-së, Autoriteti Publik nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë të nenit të sipërcituar.*

Neni 17 i LDI-së, në pikën 6 të tij parashikon se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Për sa cituar më sipër, Autoriteti Publik nuk mund të refuzojë në tërësi kërkesat e ankuesit, të cilat lidhen me: *“Një kopje të kontratës/kontratave noteriale së sipërmarrjes, të lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues (projektues) që ka kryer punimet”* dhe *“Një kopje të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronarëve që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta”*, duke u bazuar në parashikimet e ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe tek shkronja “a” e pikës 1 të nenit 17 të LDI-së, pa analizuar në tërësi legjislacionin e sipërcituar.

Autoriteti Publik, duke qenë se dokumentet e mësipërme janë pjesë e dosjes së lejes së ndërtimit/zhvillimit, në respekt të ligjit nr. 107/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, e ndryshuar, neni 15, pika 1, përcakton dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me leje ndërtimi, për ato zhvillime për të cilat është përgjegjës Këshilli Kombëtar i Territorit: *“b) Dokumentit që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, duke përfshirë vërtetimet e pronësisë për zonat kadastrale që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar, si dhe marrëveshjet përkatëse; d) Grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit; dh) Preventivi; f) Mandatpagesën/at e tarifës/ave të aplikimit, në rast se parashikohet...”*, si dhe parashikimeve të pikës 6 të nenit 17 të LDI-së, duhet t’i kishte mundësuar ankuesit një kopje të dokumentacionit të kërkuar, duke anonimizuar të dhënat personale të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimit të pikës 23 të nenit 3 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në kontratat e përmendura në pikat e mësipërme.

Gjithashtu, Komisioneri e gjen të gabuar interpretimin e Autoritetit Publik se: *“...kopje të Preventivëve të Punimeve nuk mund të vihet në dispozicion bazuar në nenin 17, pika 1, shkronja “c”, e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit, siç janë preventivat... mbështetur edhe në nenin 8, pika 1, shkronjat “e” dhe “g” të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to... e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore; g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi...”*.

Në rastin konkret nuk ndodhemi përpara asnjë nga rasteve të sipërcituara. Sipas përkufizimit të “Preventivit të Punimeve” dhënë në VKM nr. 354, datë 11.05.2016: *“Preventiv paraprak” përkufizohen si një përcaktim i përafërt i shpenzimeve, në bazë të projektimit paraprak. Ato janë baza të përkohshme, për çdo planifikim financiar dhe janë bazuar në gjetjet e projektimit paraprak, llogaritjet sasiore, informacionit shpjegues, lidhur me faktorët e projektimit, proceset dhe kushtet, duke përfshirë informacion mbi truallin e ndërtimit, si dhe lidhjen me infrastrukturën përreth.”*

Gjithashtu duhet theksuar se bazuar legjislacionit të sipërcituar, është një nga dokumentet i cili depozitohet dhe administrohet në dosjen e lejes së ndërtimit/zhvillimit. Ndër të tjera vërehet se ky dokument nuk është vendosur në dispozicion të ankuesit vetëm për tre

projekte, ndërkohë që për projektet e tjera është vendosur në dispozicion dokumenti i kërkuar.

Rrjedhimisht, publikimi i tyre, nuk mund të dëmtojë automatikisht të drejtën e autorit pasi jo domosdoshmerisht kemi të bëjmë me *krijime arkitekturore të cilat përfshijnë vizatimet, planet, skicat, krijimet grafike, krijimet tredimensionale, ilustrimet... etj.* Megjithatë, në çdo rast ekzistenca apo jo e këtyre elementeve duhet të analizohet nga Autoriteti Publik dhe në rast se vlerëson se dokumenti përmban të dhëna që lidhen me të drejtën e autorit, ai mbart detyrimin që të zbatojë parashikimet e pikes 6 të nenit 17 të LDI.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se dokumentacioni i kërkuar përbën informacion publik bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI-së, sipas së cilës: *“Informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm, pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarës. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Në përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3 e nenit 3 të LDI-së parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, ankuesi është OJF, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisé (aplikimi nr. 37374/05, datë 14.04.2009)”* vlerësoi se pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dyja palëve.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në shkronjat “b” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr.

49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, me nr. 2721 prot., datë 23.10.2025 (vijuar me nr. 2721/3/2 prot., datë 20.11.2025, nr. 680 prot., datë 04.03.2026 dhe nr. 680/4 prot., datë 25.06.2026), ndaj Autoritetit Publik, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas vijimit të Ankesës nr. 680/4 prot., datë 25.06.2026, konkretisht: “1- a) *Një kopje të kontratës/kontratave noteriale së sipërmarrjes, të lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues (projektues) që ka kryer punimet; b) Një kopje të dokumenteve që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronarëve që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta; c) Një kopje të dokumentit që vërteton pagesën e Taksës në Infrastrukturë*”; “2- *Për objektet “Lana Riverside Residences”, “Bond Tower” dhe “Tirana Gate”: Dokumentin e Preventivit të punimeve dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis*”, brenda datës 21.07.2026, në përputhje me parashikimet e pikës 6 të nenit 17 dhe pikës 6/1 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot, më datë 13.07.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi